



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

P/VENDIM

NR _____, DATË _____._____.2026

**“PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VKB-NË NR. 101 DATË 22.12.2025 “PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT
VJETOR 2026”**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një shtesë dhe ndryshim në VKB-në nr. 101 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”, në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe VKB Nr 101 datë 22.12.2025 “Për nje shtesë në VKB-në nr.101 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” sipas Aneksit Nr 1, bashkëlidhur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretari i Këshillit

Bexhet Baxhella



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË GJIROKASTËR

P/ V E N D I M

Nr. ____ Datë. ____ / ____ /2026

**“ PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË
GJIROKASTËR DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E TIJ ”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, Ligjit Nr.103/2014 “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet”, Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit, Akteve Ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Konventa për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, shkresës së Prefektit Gjirokastrë Nr.1006 Prot., datë 17.12.2024, protokolluar me tonën Nr.11482 Prot., datë 17.12.2024 si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____ / ____ /2026 :

V E N D O S I:

1. Të miratojë krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Gjirokastrë dhe rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij, që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Gjirokastrë.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Bexhet Baxhella

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

P/VENDIM

Nr. __ date __. __. 2026.

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE
PËR MUAJIN GUSHT 01-31.08.2026.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 101 datë, 22.12.2025 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 3.000.000 lekë/vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Gusht 2026, 50 individë/ familje me fond 146,149 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ .2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMI E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK- NDIHMËN EKONOMIKE DERI NE 6% PËR MUAJIN GUSHT 01-31.08.2026.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, date 04.09.2019 për “Për Përcaktimin e Procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, me propozim të kryetarit të bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Gusht 2026, 6 (gjashtë), individë/familje** me fond **19,957 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

P/VENDIM

Nr. _____, datë _____.2026

PËR

DHËNIEN E TITULLIT “ QYTETAR NDERI” PËR Z. ARJAN JONUZ SHEHU

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit", Ligji nr 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit, V.K.M Nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënie e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës 02/06/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie e titullit “ Qytetar Nderi” për Z. Arjan Jonuz Shehu me motivacionin :
“Për kontributin e shquar në rruajtjen dhe përcjelljen në breza të vlerave origjinale të trashëgimisë folklorike dhe identitetit kulturor, si një prej interpretuesëve më të spikatur të polifonisë gjirokastrite, si zëri i gjallë që vazhdon traditën e këngës së të parëve”
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Gjirokastrë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”

SEKRETAR I KËSHILLIT

Bexhet BAXHELLA

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ